



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi**

**Datë:**

**Numri i seancës për këtë çështje:**

*Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).*

**A. Informacioni bazë**

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni I Pavarur I Kualifikimit; Objekti: Rivlerësimi kalimtar I subjektit të rivlerësimit z. Ramadan Troci</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z.Ramadan Troci</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme, kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Nuk pati shtyrje të seancës.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Shpallja e vendimit u shty në datë 14 Nëntor, ora 10.00</i>

**B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca**

Tupa gjykyese (emrat)	<i>Pamela Qirko, Suela Zhegu, Genta Tafa Bungo</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Ardian Leka</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Në seancë ishin të pranishëm rreth 15-20 persona.</i>
Media e pranishme:	<i>Media ishte e pranishme.</i>

<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	<b>Po/Jo</b>	<b>Nëse po, si u justifikua ai?</b>	<b>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</b>
	<i>Rivlerësimi kalimtar i subjektit është bërë sipas të tre kriterëve.</i>		

D. Përbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
	<p>Sipas Raportit të ILDKPKI në pronësi të subjektit z. Ramadan Troci ndodhet:            - (1) një apartament banimi në Kashar, me sip. 94.4 m2, si edhe - (2) një depozitë bankare në vlerën 2.8 milion lekë. Për këto pasuri KPK vlerëson se subjekti ka një mungesë likuiditetesh në vlerën 57 mijë lekë.</p> <p>KPK nga një hetim i pavarur administrativ ka hedhur dyshime edhe për disa pasuri të tjera të subjektit. Konkretisht: -(1) Subjekti jeton në një apt. me qira në zonën e Pazarit të Vjetër. Qiraja për këtë shtëpi është nën vlerën e tregut. KPK ka shprehur dyshime lidhur me pronësinë e shtetasit A.Sh. -(2) Rezulton se mjetin e ka përdorur disa here për dalje jashtë shtetit një makine Tiguan, e cila figuron në pronësi të vëllait të subjektit. Mjeti i blere në emër të shtetasit NT kushton 13 mijë euro (pa detyrime doganore). Në policinë e sigurimit përdorues janë subjekti i rivlerësimit z. Ramadan Troci dhe bashkëshortja e tij. Sipas KPK targa e automjetit koïncidon me datëlindjen dhe inicialet e subjektit. -(3) Sipas KPK në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit NT, është një pasurie e paluajtshme e cila ndodhet në të njëjten godinë ku banon edhe subjekti i rivlerësimit. Vëllai i subjektit ka mungesë të pasurive të ligjshme. Shtetasi NT nuk e justifikon pasurinë e tij në vlerën 19 mln lekesh. -(4) KPK konstatoi se baxhanaku i subjektit të rivlerësimit, shtetasi RM, është bashke-aksioner në një shoqëri minerare në Bulqizë, dhe në 2010 ka blerë 33% e kuotave. Në kontratën e shitblerjes nuk ka cmim për kuotat. KPK ngre dyshime për pronësinë e këtyre kuotave pasi subjekti i rivlerësimit ka qënë prokuror në Dibër dhe ka patur disa çështje hetimore lidhur me aksidentet në punë në minierat e Bulqizës, për të cilat ka vendosur mosfillim apo pushim të çështjes. Shtetasi ED perfaqësues ligjor i shoqërisë minerare ka marrëdhënie të ngushta me shtetasin RM. (5.) Dyshime nëse subjekti i rivlerësimit ka pjesë në një objekt ndërtimi 32 m2 në oborrin e babit të tij në Paskuqan.</p>	<p>Të dhëna nga raportet e ILDKPKI</p> <p>Relatori</p> <p>Mbrojtja</p>	<p>Trupa gjyqësore e KPK ka bërë një vlerësim të subjektit sipas nenit 4 të ligjit 84/2016, dhe ka shqyrtuar të tre kriteret e rivlerësimit: pasuria, pastërtia e figurës dhe aftësitë profesionale. Për këtë KPK është bazuar në raportet e ILDKPKI, DSIK dhe Prokurorisë së Përgjithshme si edhe ka kryer një hetim të pavarur duke pyetur persona fizikë, juridikë publikë dhe privat. Kur KPK ka cmuar se provat kanë arritur vlerën e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit 84/2016, KPK ka thirrur subjektin subjektin i rivlerësimit I ka kaluar atij barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016.</p>
	<p>Subjekti i rivlerësimit, lidhur me mungesën e likuiditetit për apt. 94.4 m2 në Tiranë dhe depozitën bankare, u shpreh se ka llogaritje gabim të likuiditeteve nga ana e KPK. Sipas subjektit të rivlerësimit, KPK ka llogaritur një mungesë likuiditeti për periudhën 2004-2007 në shumën prej 57 mijë lekësh, që e përkthyer në muaj do të thotë një mungesë prej 5800 leke në muaj, një shumë kjo plotësisht e mundur të kursehet nga subjekti. Për më tepër, subjekti u shpreh se në 2004 rezulton se KPK i ka llogaritur shpenzime vjetore rreth 600 mijë leke të reja në vit, kur kostot e jetesës në Bulqizë në 2004 sipas INSTAT-it kanë qënë 75 mijë leke në vit, ose sipas ILDKPKI 110 mijë leke në vit. Pra vetëm kjo llogaritje e gabuar justifikon disa herë shumën prej 57 mijë lekësh që është përdorur për kredinë prej 20 mijë euro. (2) Lidhur me apt me qira në zonën e Pazarit të Ri ai është apartamenti i shtetasit A. Sh, kunati i dy shokëve të mi H.S. dhe P.S. Shokët ju lutën të qëndrojnë në këtë apt i cili ishte bosh, pa anjë qira. Për hir të fëmijëve është transferuar aty. Nuk i di raportet e A. Sh. me firmën ndërtuese. Subjekti deklaroi se nuk ka pronësi tek Pazarit i Ri. (2) Lidhur me makinën Tiguan, subjekti u shpreh se ai ka përdorur makinat e miqve dhe të afërmeve të tij kur ka dalë jashtë shtetit, për të shmangur pagesën e siguracionit të makinës. (3) Lidhur me pasurinë e personave të lidhur, vëllezërve të tij, subjekti RT u shpreh se vellezërit e tij kanë jetuar dhe punuar në mënyrë të rregullt në Greqi, cka provohet me sigurimet dhe llogaritë bankare. (4) Lidhur me marrëdhënien me baxhanakun, subjekti u shpreh se ka komunikim të rrallë me të. Subjekti tha se nuk është në dijeni të pasurisë së baxhanakut. (5) Lidhur me objektin e ndërtimit prej 32 m2 në oborrin e të atit, subjekti u shpreh se nuk ka ndërtuar asnjë objekt në truallin e babit dhe nuk ka kërkuar legalizim. Ai u shpreh se babai i tij e ka ndërtuar këtë objekt, një kasolle, vetëm për një arsye për të fituar sipërfaqen e tokës. Ka ndërtuar një barake në rrethimin e këtij objekti, pa linjë ujësjesi. Ai e ka pershtatur për të fituar sipërfaqen.</p>	<p>Subjekti</p>	

D1. Pasuria	Shih seksionin e vlerësimit të aftësisë profesionale, rezulton se ka ankesa për korrupsionin.	Ankesa nga publiku	
	Nuk ka	ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Neni 39 ligjit 84/2016, subjekti u cilësua si përshtatshëm për vazhdimin e detyres	Të dhëna nga raportet e DSIK	
		Relatori	
		Mbrojtja	
		Subjekti	
		Ankesa nga publiku	
		ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Sipas Raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti është vlerësuar se ka cilesi të pranueshme në punë, vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, disiplinën në punë, sjelljen etike, morale duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit	Të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme për prokurorët	
	KPK ka bërë një hetim të pavarur dhe ka marrë në shqyrtim 10 denoncime dhe dy deshmi nga qytetar të ndryshëm, për korrupsion dhe mangësi profesionale në detyrën si prokuror. KPK ka marrë në shqyrtim 8 dosje me pasoje vdekjen apo plagosjen, ku prokurori ka vendosur mosfillim apo pushim të çështjes sepse ngjarja ka ndodhur për faj të viktimave. Janë kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme fashikujt e plote dhe një interpretim ligjor për hetimin dhe vendimmarrjen e ketyre dosjeve, PP dergoi dosjet dhe në përmbushje të ligjit ka dhënë opinion ligjor për hapat e ndërmarra. Rezultoni se Prokurori ka interpretuar gabim ligjin dhe vendimet nuk janë arsyetuar plotësisht, hetimi nuk është efektiv dhe ka neglizhencë të vazhdueshme.	Relatori	
	Lidhur me hetimet për të cilat prokurori nuk ka filluar hetim apo ka vendosur pushimin e çështjes, subjekti i rivlerësimit është shprehur se këto lidheshin me problematikat e K.Proc Penale të kohës dhe KPP sot. Subjekti u shpreh se ka patur rreth 2000 raste të tilla, rastet të cilat nuk janë ankimuar nga familjaret e viktimes. Për më tepër janë ekspertet që vlerësojnë nëse viktimat ka patur faj apo jo.	Subjekti, etj..	
<b>E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme e drejtës për të paraqitur</b>	Me hedhjen e shortit, subjekti i rivlerësimit është njohur me përbërjen e trupës gjyqësore të KPK. Subjekti është shprehur se nuk ka konflikt interesi me trupën gjyqësore. Subjekti i janë garantuar të drejtat e parashikuara në nenin 47 të ligjit 84/2016, si edhe nenet 35-40 dhe neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti është njoftuar lidhur me dosjen dhe i është lënë 15 ditë kohë për tu njohur me të dhe për të marrë një kopje të saj. Subjekti i rivlerësimit i ka ushtruar këto të drejta. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumente plotësuese, depozituar prova dhe ka kërkuar thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve. KPK ka vendosur të refuzojë pjesërisht kërkesën e subjektit si të pabazuar në prova dhe ligj bazuar në nenin 49(6) të ligjit 84/2016. Subjekti është thirrur në përputhje me nenin 55 të ligjit 84/2016 në seancë dëgjimore për të dhënë parashtrimet e tij. Subjekti ju dha e drejta të fliste vet si edhe të mbrohej me anë të një avokati. Subjekti të rivlerësimit ju la një kohë e arsyeshme për të paraqitur argumentet dhe për tu dëgjuar. Sjellja e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN ishte etike.		